



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 17 Dhjetor 2020

Nr: 36

VENDIM

**PËR MIRATIMIN E MODELIT DHE SPECIFIKIMEVE TË KUTIVE TË VOTIMIT DHE
KUTIVE TË MATERIALEVE ZGJEDHORE QË DO TË PËRDOREN NË ZGJEDHJET
PËR KUVEND TË DATËS 25 PRILL 2021**

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, bazuar në nenin 19 paragrafët 1, shkronja “n”, dhe 2, nenin 99, paragrafët 1 dhe 2, nenin 100, paragrafi 1, shkronjat “a” dhe “b”, dhe nenin 104, paragrafi 1, të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, pasi shqyrtoi propozimet dhe dokumentacionin e paraqitur;

V Ë R E N:

Ligji Nr.10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, në nenin 99, përcakton detyrimin e KQZ-së për dërgimin në KZAZ të materialeve zgjedhore për çdo qendër votimi.

Në bazë të përcaktimeve të Kodit Zgjedhor, dispozitave si më poshtë referuar:

- a) neni 99, paragrafi 1, përcakton se “KQZ-ja dërgon në selitë e KZAZ-ve, jo më vonë se 3 ditë para datës së zgjedhjeve, materialet e mëposhtme zgjedhore, të ndara në kuti të veçanta për çdo qendër votimi”;
- b) neni 99, paragrafi 2 shkronja “a”, përcakton se “Përveç kutive me materialet zgjedhore, sipas pikës 1 të këtij neni, KZAZ-ve u jepen kuti votimi për çdo qendër votimi, në përputhje me kërkesat e këtij Kodi”;
- c) neni 100, paragrafi 1, shkronjat “a” dhe “b”, përcaktojnë se: KZAZ-ja, jo më vonë se 15 orë para hapjes së votimit, u shpërndan materialet zgjedhore KQV-ve nën juridiksionin e saj. Kryetari dhe sekretari i KQV-së, të shoqëruar nga çdo anëtar tjetër që kërkon, paraqiten në



Data: 23 Dhjetor 2020
Nr: 2584

Për miratimin e modelit dhe specifikimeve të kutive të votimit dhe kutive të materialeve zgjedhore që do të përdoren në zgjedhjet për Kuvend të datës 25 Prill 2021

selinë e KZAZ-së dhe tërheqin kutinë me materialet zgjedhore, sipas nenit 99 pika 1 të këtij Kodi, dhe kutinë/kutitë e votimit;

ç) neni 104, paragrafi 1, përcakton se “Në zgjedhjet për Kuvendin, në qendrën e votimit vendoset vetëm një kuti votimi.”

Në zgjedhjet pararendëse, që nga viti 2009 e në vijim, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka përdorur kuti votimi me volum 83 litra dhe kuti të materialeve zgjedhore me volum 60 litra, të cilat kanë rezultuar të përshtatshme, me kapacitet të mjaftueshëm për fletët e votimit dhe për materialet zgjedhore, kanë qënë rezistente dhe nuk ka pasur problematikë gjatë transportit të tyre. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve administron numër të mjaftueshëm të kutive të votimit dhe të kutive të materialeve zgjedhore, në gjendje fizike të pranueshme, të cilat mund të ripërdoren edhe në këtë proces zgjedhor.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 19, paragrafët 1, shkronja “n”, dhe 2, nenin 99, paragrafët 1 dhe 2, nenin 100, paragrafi 1, shkronjat “a” dhe “b”, dhe nenin 104, paragrafi 1, të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S :

1. Të miratojë modelin dhe specifikimet teknike të kutive të votimit, që do të përdoren në zgjedhjet për Kuvend të datës 25 Prill 2021, sipas lidhjes 1, pjesa I, bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Të miratojë modelin dhe specifikimet teknike të kutive të materialeve zgjedhore, që do të përdoren në zgjedhjet për Kuvend të datës 25 Prill 2021, sipas lidhjes 1, pjesa II, bashkëlidhur këtij vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI



Data: 23 Dhjetor 2020
Nr: 2584

Për miratimin e modelit dhe specifikimeve të kutive të votimit dhe kutive të materialeve zgjedhore që do të përdoren në zgjedhjet për Kuvend të datës 25 Prill 2021

LIDHJA 1

Pjesa I

Modeli i Kutisë së Votimit:




Kapaciteti i kutisë së votimit: 83 litra (afërsisht me kapacitet për 1.000 fletë votimi me përmasa A3)

Specifikimet:

- transparente,
- plastike,
- e sigurtë,
- e papaloshhme,
- e ripërdorshme
- kutia mbyllet me 4 vula me kode sigurie në katër anët e saj dhe 1 vulë me kod sigurie në hapësirën e kapakut ku hidhen fletët e votimit.

Pjesa II

Modeli i Kutisë së Materialeve Zgjedhore:



Kapaciteti i kutisë së materialeve zgjedhore: 60 litra

Specifikimet:

- transparente,
- plastike,
- e sigurtë,
- e papaloshhme,
- e ripërdorshme
- kutia mbyllet me 4 vula me kode sigurie në katër anët e saj.



Data: 23 Dhjetor 2020
Nr. 2584

Për miratimin e modelit dhe specifikimeve të kutive të votimit dhe kutive të materialeve zgjedhore që do të përdoren në zgjedhjet për Kuvend të datës 25 Prill 2021